**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr** 14133 **rep**
**Nr** 1604 **kol.**

NOTER TIRANË

**KONTRATE E SHITBLERJES**
**(KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR)**

Ne Tirane, sot me date 31.12.2003, para meje noter Agim.XH.Robo me zyre noterie ne rrugen "Ismail Qemali" P.27/1, u paraqiten personalisht Ortaket e shoqerise tregetare "ALBECORP" F.B.O sh.p.k.si pale kontraktuese me cilesite perkatese:

**SHITESI**: SHOQERIA "DANISMAC" sh.a me seli ne adresen Bul.du Prince Henri, L-1724, Luxemburg RC Luxemburg B 29850, zoterues me 75% te kuotave te kapitalit themeltar, perfaqesuar me autorizim Nr.374, Date________,nga zoti Daniel Israel, biri Clement-it,dl.18.02.1969, banues ne Bruksel, nr.pasaportes 66320 J.

**BLERESI**:ZOTI IRFAN HYSENBELLIU, biri Hasanit, 08.04.1959, banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha", me nr.pasaportes 1762730, zoterues e 25% te kuotave te kapitalit themeltar.

te dy palet me zotesi te plote juridike e per te vepruar ,qe me vullnetin e tyre te lire kerkuan nga une redaktimin e Aktit noterial, Kontrate e shitblerjes se kuotave ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare"

**PERMBAJTJA:**

Me vendimin nr.12.234/5320 date 28.05.1998 te gjykates se shkalles se pare Tirane, jane depozituar prane Regjistrit Tregetar, aktet e shoqerise "ALBECORP" F.B.O. sh.p.k.

Sipas rregjistrimit perkates, Shoqeria "DANISMAC" sh.a. me cilesine e Ortakut ( me poshte Shitesi) eshte zoteruese mbi 75% te kuotave te kapitalit themeltar, ndersa zoti Irfan Hysenbelliu, (me poshte Bleresi) eshte Ortak zoterues mbi 25 % te kuotave.

Sipas vendimit nr.2 date 31.12.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "ALBECORP" F.B.O eshte vendosur:Miratimi I Transferimit te kuotave prej 75% .

**SHITESI**:Shoqeria "DANISMAC" sh.a nepermjet Perfaqesuesit te saj zotit Daniel Israel, I shet Bleresit zotit Irfan Hysenbelliu 75%

(shtatedhjete e pese)te kuotave zoteruese te saj mbi kapitalin themeltar kundrejt vleftes se shitjes prej **890.635(teteqind e nentedhjete mije e gjashteqind e tridhjete e pese ) USD.**

**BLERESI**:Zoti Irfan Hysenbelliu pranon blerjen e kuotave prej 75% (shtatedhjete e pese) te ofruara nga Shitesi, kundrejt vleftes prej **890.635(teteqind e nentedhjete mije e gjashteqind e tridhjete e pese ) USD**

Shlyerja e vleftes totale te kuotave te shitura sipas deklarimit te perbashket te paleve eshte bere njeheresh dhe perfundimisht nga pala Blerese zoti Irfan Hysenbelliu.Me nenshkrimin dhe vertetimin e kesaj Kontrate, zoti Irfan Hysenbelliu fiton te drejten e pronesise mbi kuotat prej 75% te kapitalit themeltar si dhe cdo te drejte reale qe rrjedh prej kesaj pronesie.
Shitesi, shoqeria "DANISMAC" sh.a humbet cdo te drejte pronesie mbi kuotat e shitura si dhe cilesine e Ortakut ne shoqerine "ALBECORP" F.B.O sh.p.k.

Ortak I Vetem I shoqerise "ALBECORP" F.B.O sh.p.k. zoterues ekskluziv I 100% (njeqind) te kuotave te kapitalit themeltar te saj eshte zoti Irfan Hysenbelliu.

Ne percaktimin e vleftes se shitjes dhe menyrat e shlyerjes se saj u morr me konsiderate me te gjitha efektet ligjore Akt Marveshja e dates 09.09.2003 e hartuar midis paleve ne gjuhen angleze, e perkthyer ne shqip dhe legalizuar me vertetimin nr.4832 date 12.09.2003 nga noteri.
Shoqeria DANISMAC Sh.a duke firmosur kete kontrate , konfirmon se ajo ka marre shumen e plote prej 890.635 sipas Marreveshjes se blerjes se aksioneve te nenshkruar me 09.09.2003.
Sa me siper Kontrata e shitblerjes e hartuar ne tre faqe,ne pese ekzemplare me fuqi te barabarte, iu lexohet paleve me ze te larte.Per palen shitese qe nuk njeh gjuhen shqipe, perkthimi u krye nga zoti Bashkim Haxhi, i biri I Sabriut, lindur ne Vlore me date 15.05.1943 i cili deklaroi se perktheu korrektesisht permbajtjen e saj.Pala shitese deklaron se ka kuptuar permbajtjen e saj dhe nuk ka asnje kontestim per perkthimin e kryer.

Palet pajisen me aktin perkates, njeri prej tyre depozitohet prane kesaj zyre.

Une noteri qe redaktova Kontraten e Shitblerjes ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" ,pasi u binda se palet kane shprehur vullnetin e tyre te lire dhe aktin e gjej ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.